

Syllabusi i lëndës: Psikologji zhvillimore e avancuar

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Filozofik – Departamenti i Psikologjisë
Titulli i lëndës:	Psikologjia zhvillimore e avancuar
Niveli:	Master
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	II
Numri i orëve në javë:	2+2
Vlera në kredi – ECTS:	6
Koha / lokacioni:	Për t'u definuar
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. Dr. Neki Juniku
Detajet kontaktuese:	Neki.juniku@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës	
Përshkrimi i lëndës	Kjo lëndë ofron një shikim të avancuar në teoritë dhe hulumtimet bashkëkohore të qasjes jetë-gjatësore në psikologjinë zhvillimore. Lënda to të mundësojë të kuptuarit e ndryshimeve të rëndësishme zhvillimore gjatë tërë jetës. Rëndësi do ti jipet në ndryshimet tipike të natyrës fizike, kognitive, emocionale si dhe zhvillimeve sociale (tranzicionale) si dhe do të përqëndrohet në çështjet e diversitetit dhe socializmit të ndërlidhur me perceptimin e zhvillimit të njeriut.
Qëllimet e lëndës:	Zgjerimin e njohurive dhe të kuptuarit e psikologjisë zhvillimore duke e ndërlidhur specifikisht me kontekstin klinik.
Rezultatet e pritura të nxënies:	Pas përfundimit me sukses të kësaj lënde, studenti duhet të jetë në gjendje të: <ol style="list-style-type: none"> 1. Definojë "psikologjinë zhvillimore" dhe identifikojë çështjet themelore në këtë fushë studimi. 2. Identifikojë komponentët kryesorë të teorive të ndryshme të psikologjisë zhvillimore. 3. Përshkruajë zhvillimin fizik, njohës dhe psiko-socialë me jetëgjatësi. 4. Definojë çrregullimet mendore nga pikëpamja e zhvillimit. 5. Praktikojë bërjen e diagnozave multiaksiale, duke shfrytëzuar DSM-në aktuale. 6. Përshkruajë kriteret për fëmijën e madh dhe kategoritë diagnostifikuese të adoleshencës. 7. Identifikojë faktorët etiologjikë të përfshirë në zhvillimin e fëmijës dhe çrregullimet e adoleshentëve. 8. Shpjegojë lidhjet e mundshme midis vonësive të zhvillimit dhe përparimet si dhe çrregullimet e ndryshme të fëmijërisë.

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet			5
Ushtrime në teren			
Kollokfiume,seminare	2	5	10
Detyra të shtëpisë	2	5	10
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	3	15	45
Përgaditja përfundimtare për provim			10
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)			5
Projektet,prezentimet ,etj			5
Totali			150
Metodologjia e mësimdhënies:	Të gjitha ligjëratat do të theksojnë qasjen jetë-gjatësore. Materialet e e leximit do ti jipen studentëve para ligjeratës dhe do të kërkohet që ata ti lexojnë materialet para se ti vijnë në ligjërata. Pjesëmarrja në ligjërata do të jetë e obliguar.		
Metodat e vlerësimit:	Pjesëmarrja dhe konsultimet e rregullta: 10% Kuizet: 15% Punim seminarik: 25% Provimi final: 50%		
Literatura			
Literatura bazë:	Marc H. Bornstein, Marc H. Bornstein Michael E. Lamb (1999). Developmental Psychology: An Advanced Textbook		
Literatura shtesë:	Berger, K. S. (2008). The developing person: Through the lifespan. Ëorth Publishers: Neë York.		

Plani i detajizuar i punës për një semestër	
Javët	Temat
Java 1	Hyrje
Java 2;	Teoritë e zhvillimit – hyrje në neuro-biologji
Java 3;	Fillimi i jetës; rreziqet dhe rezilienca
Java 4;	Foshnjëria – zhvillimi
Java 5;	Fëmijëria e hershme
Ëeek 6;	Fëmijëria e mesme – zhvillimi
Ëeek 7;	Adoleshenca 1
Ëeek 8;	Adoleshenca 1
Ëeek 9;	Rinia e hershme
Ëeek 10;	Rinia e hershme dhe e mesme
Ëeek 11;	Rinia e mesme dhe e vonshme
Ëeek 12;	Vdekja dhe pikëllimi
Ëeek 13;	Rishikim i qasjes jetë-gjatësore
Ëeek 14;	Rishikim i qasjes jetë-gjatësore 2
Ëeek 15;	Përmbledhje

Definimi i përbashkët i rregullave me studentët:
<ul style="list-style-type: none"> - Mësimdhënësi do të ndihmojë të nxënit e studentëve dhe arritjet e qëllimeve të lëndës përmes vlerësimit të progresit të studentëve në vazhdimësi dhe në një mënyrë që ju ofron atyre prapaveprim (feedback) të përdorshëm; - Studentët janë fuqimisht të inkurajuar që të bëjnë pyetje, të komentojnë dhe të marrin pjesë në diskutimet klasore; - Sjellja e duhur akademike është e domosdoshme. Kopjimi i punës së të tjerëve, përdorimi i materialeve të pa-aprovuara gjatë provimeve dhe kuizeve, apo marrja (duplikimi) e/i punës së tjetrit paraqet mashtrim dhe nuk do të tolerohet; - Përdorimi i lap-topëve (kompjuterëve) lejohet vetëm me aprovimin paraprak të mësimdhënësit; - Përdorimi i telefonave mobil nuk është i lejuar;